



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.156/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e koalicionit PDK-AAK-NISMA, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të vendosjes së postereve në shtylla publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 09.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e koalicionit PDK-AAK-NISMA, dhe subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 3,100.00 (tremijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarrimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 07.06.2017, nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, me të cilën pretendon se me datën 07.06.2017 aktivistet e koalicionit PDK-AAK-NISMA kane vërejtur se në fshatin Pagarush të Malishevës, Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ka vendosur në shtylla elektrike dhe rrugë postere reklamuese të kandidatëve për deputete nga ky subjekt politik.

Me këtë rast parashtuesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4, pika 1, e Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014 të KQZ-së. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjekte politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në kërkesën për përgjigje në ankesë dërguar subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me datë 07.06.2017, nuk kanë jep ndonjë sqarim lidhur me ankesën. Koalicioni PDK-AAK-NISMA, me datën 08.06.2017, ka paraqitur kërkesë për tërheqje të ankesës, Anr.156/2017, të parashtruar kundër subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli vlerëson se nga fotografit e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se posterat e kandidatëve për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, janë vendosur në shtylla publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posteret e kandidateve për deputet nga subjekti në fjalë, janë vendosur dhe janë ngjitur në shtylla publike.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se shkelja e njëjtë nga subjekti politik LVV, është përsëritur disa herë në këtë proces zgjedhor, ku për kundër këtij fakti posterat e kandidatëve për deputet nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, janë vendosur në shtylla publike.

Lidhur me kërkesën e parashtruar nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, e datës 08.06.2017, për tërheqjen e ankesës Anr.156/2017 të datës 07.06.2017, e parashtruar ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, paneli vlerëson se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut dhe se në këtë rast tërheqja e njëjës prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ. Në neni 54 par.1 të Ligjit për Procedurën Administratave është parashikuar që “*Tërheqja e njëjës prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ në qoftë se organi kompetent i administratës publike gjykon se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut ose në interesin ligjor të palëve të tjera në procedim*”. Paneli nuk e bëri lejimin e tërheqjes së ankesës sepse ka vlerësuar se veprimi i subjektit politik LVV, ka cenuara interesin e publikut kjo aq më tepër kur kërkesës nuk iu ka shoqëruar asnjë provë në bazë të cilave do të dëshmohej se është bërë riparimi i shkeljes në teren, duke i tërhequr posterat nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 32 par.2, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) të LZP-së, lidhur me nenin 51.4 të LPA-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr. 156/2017 më datën 09.06.2017



Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.